

Hapet thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Aksaray, Turqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

Në kuadër të programit Erasmus+ është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin Aksaray, Turqi, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021-2022.

<https://www.aksaray.edu.tr/>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor (1 semestër);

- Master (1 semestër);

Fushat e studimit:

- Shkenca mjedisore;
- Biologji dhe shkencat e saj;
- Teknologji informacioni dhe Komunikimi.

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit ju lutem referohuni linkut:

<https://ogris.aksaray.edu.tr/akademik-takvim>

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (800 EUR në muaj);

- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus+ nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Listë notash (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze ose turke në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit);
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B1 i gjuhës turke ose angleze në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit)

- Dokumenti Learning Agreement*

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshatën në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Dokumentat e nevojshme për aplikim për nivelin Master:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;

- Vërtetim studentit (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Diplomë Bachelor;
- Listë notash Bachelor (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Listë notash Master (në gjuhën shqipe dhe të përkthyer në mënyrë zyrtare në Turqisht ose Anglisht);
- Letër motivimi (në gjuhën angleze ose turke në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit);
- Certifikata e gjuhës së huaj (niveli B1 i gjuhës turke ose angleze në varësi të gjuhës në të cilën zhvillohet programi i studimit)
- Dokumenti Learning Agreement*

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing-2-1.docx

Afati për aplikim: 03 Dhjetor 2021

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!